




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 72/2021

Datë: 24 mars 2021

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragraf 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Adnan Isufi, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK/34/2020/ GJTHPR - AD/ GJTHPR/ 46/20, të datës 21 janar 2021, pas seancës dëgjimore të mbajtur më datë 4 mars 2021, në pajtim me nenin 14 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 19 dhe 20 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, nxjerr këtë:

#### V E N D I M

**Adnan Isufi**, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, **nuk është përgjegjës** për shkeljen disiplinore të përcaktuar nga neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.2, dhe 2.15, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

#### A r s y e t i m

Paneli hetimi i themeluar me vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës me numër KGJK.nr.258/2020, të datës 18 nëntor 2020, për lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/34/2020/ GJTHPR - AD/ GJTHPR/ 46/20, i ka paraqitur Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin mbi hetimin e bërë lidhur me shkeljen disiplinore të pretenduar të gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Adnan Isufi, i cili dyshohet se në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 20.10.2020, për lëndën penale PM.nr.154/20, ka shkelur detyrat e gjyqtarit të përcaktuara në neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.2, dhe 2.15, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve duke treguar mungese të paanshmërisë dhe duke mos respektuar barazinë e palëve ne procedurë.

Për të shqyrtuar këtë çështje disiplinore Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 24 mars 2021, ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore në të cilën morën pjesë kryesuesja e panelit hetimor gjyqtarja Ajsere Skenderi dhe subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari Adnan Isufi. Kryesuesja e panelit hetimor në fillim të seancës dhe në fjalën përfundimtare, deklaroi se qëndron pran raportit të bërë me shkrim dhe provave të bashkangjitura dhe ka kërkuar nga KGJK-ja që të vendos lidhur me pretendimet e Autoritetit Kompetent se a ka apo nuk ka pasur shkelje disiplinore nga gjyqtari Adnan Isufi gjatë zhvillimit të seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 20.10.2020 në lëndën penale PM.nr.154/20.

Gjyqtari Adnan Isufi në seancën dëgjimore, deklaroi se qëndron në tërësi pran deklaratave të dhëna para Autoritetit Kompetent dhe para panelit hetimor. Ka theksuar se këtë seancë gjyqësore e kishte filluar sikur edhe me çdo seancë tjetër dhe se te gjitha veprimet që i ka ndërmarrë kanë qenë të ligjshme, objektive dhe të paanshme, por të orientuara për mbarëvajtjen e gjykimit dhe pa zvarritje te panevojshme te procedurës.

Për të vërtetuar drejt gjendjen faktike Këshilli Gjyqësorë i Kosovës administrojë provat materiale siç janë: Raporti mbi provat dhe faktet e mbledhura gjatë procedurës hetimore i datës 21 janar 2021, parashtresën për sjellje të pahijshme të paraqitur me datë 23.10.2020 nga av. \_\_\_\_\_, kërkesën për inicim të procedurës disiplinore të Autoritetit Kompetent, Procesverbalin e seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 07.10.2020, shkresën e gjyqtarit të datës 13.10.2020, shkresën e av mbrojtës të datës 09.10.2020, shkresën e gjyqtari Isufi të datës 08.10.2020, procesverbalin i seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 14.10.2020, shënimin zyrtar të datës 05.10.2020, Urdhërim për ekzaminim psikiatrik të datës 20.10.2020, Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 20.10.2020, kërkesën për Gjykatën Themelore se bashku me raportet mjekësore për të miturën F \_\_\_\_\_ flet lëshimin e poliklinikës “\_\_\_\_\_” të datës 11.09.2020 dhe raportin e psikiatrisë forenzike të Kosovës për lëndën Pm.nr.154/20 të datës 11.11.2020.


Pas vlerësimit të gjitha provave një nga një dhe të gjitha së bashku, Këshilli Gjyqësor i Kosovës vlerësojë se nuk qëndron pretendimi i Autoritetit Kompetent se gjyqtari Isufi në seancën e shqyrtimit gjyqësorë për lëndën penale PM.nr.154/20, nuk ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.2, dhe 2.15, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Nga provat e prezantuara nga kryesuesja e panelit hetimor, përkatësisht nga shkresat e lëndës penale PM.nr.154/20, nuk u vërtetua se gjyqtari Adnan Isufi gjatë mbajtjes se seancës gjyqësore të datës 20.10.2020 të këtë trajtuar palët dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë në mënyrë jo të barabartë. Përkundrazi në bazë të procesverbalit të seancës gjyqësore të datë 20.10.2020, shihet se gjyqtari Isufi gjithë rrjedhën e seancës e kishte drejtuar bazuar në ligje dhe në respektim të kodit të etikës për gjyqtar. Është nën autoritetin e gjyqtarit që të sigurohet disiplina dhe mbarëvajtja e shqyrtimit gjyqësor ndërsa te tjerët janë të thirrur ti respektojnë ato.

Nga e gjithë kjo KGJK-ja vlerësoj se gjyqtari në veprimet e gjyqtarit Adnan Isufi nuk përmbushen elementet e sjelljes së pahijshme disiplinore, nga nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.2, dhe 2.15, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të pretenduara nga ankuesi.

Nga sa u tha me lartë u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Këshilli Gjyqësor i Kosovës**  
**KGJK.nr.72/2021, datë: 24 mars 2021**



**Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës**

**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejt ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- *Aferdita Bytyqi, Kryetare, Gjykata Themelore në Prishtinë;*
- *Adnan Isufi, Gjyqtar, Gjykata Themelore në Prishtinë;*
- *Shkelzen Maliqi, Drejtor i Përgjithshëm i SKGJK-së;*
- *Arkivit.*